

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Mos hiq dorë nga Kosova"/ Vuçiq jep dorëheqjen si president i Serbisë, mesazhi për pasardhësin - Infor mohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/mos-hiq-dore-nga-kosova-vucic-jep-doreheqjen-si-president-i-serbise-mes-azhi-per-pasardhesin/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 19:35:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 19:24:53 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	96897c25685493cf3a4f08a6cf24fc88678358a13bbc6ca477a9c6d374c1b9fc
TEKSTI	45a8867cff9643f0761446dede0b0cd515701bfa678b94af710700a436e8c5ef
PAMJA	087fb8a37e738f25d528a7dc783a06843aaed64adb27d898a5d0ba4ec5cdb98

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5abc6fc8db7268fa60c75b52c11a30cfc440aab332b4cb4f817b87777995959f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3aac5177b059e894026952c5b076c374c5dd6b2fda5f20c0a9390b2c535810d8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/5abc6fc8db7268fa60c75b52c11a30cfc440aab332b4cb4f817b87777995959f

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » "Mos hiq dorë nga Kosova"/ Vuçiç jep dorëheqjen si president i Serbisë, mesazhi për pasardhësin

KOSOVË

Demo

"Mos hiq dorë nga Kosova"/ Vuçiç jep dorëheqjen si president i Serbisë, mesazhi për pasardhësin

SEPTEMBER 27, 2026



Aleksandar Vuçiç ka dhënë zyrtarisht dorëheqjen nga posti i presidentit të Serbisë, duke e mbyllur para kohe mandatin e tij të dytë. Dorëheqja i hap rrugë zgjedhjeve të parakohshme presidenciale, ndërsa Vuçiç pritet të përfshihet në garën parlamentare të 25 tetorit me synimin për të kandiduar për postin e kryeministrit.

Në fjalimin e largimit, Vuçiç falënderoi qytetarët serbë për besimin gjatë dy mandateve të tij në krye të shtetit.

"Jam mirënjohës ndaj qytetarëve që më kanë treguar besimin dy herë. Sot është dita kur paraqes dorëheqjen time."

Gjatë fjalimit, ai bëri edhe një bilanc të periudhës së tij në pushtet, duke u ndalur te ekonomia, punësimi, borxhi publik dhe infrastruktura. Vuçiç foli gjithashtu për prioritetet që, sipas tij, duhet të ndjekë udhëheqja e ardhshme, duke përmendur zhvillimin ekonomik, arsimin, inteligjencën artificiale dhe teknologjitë e reja.

Ai nuk la pa përmendur Kosovën, duke thënë se Serbia duhet të mbrojë interesat e saj kombëtare dhe serbët që jetojnë në Kosovë.

"Të gjithë do të duhet t'i rezistojnë heqjes dorë nga Kosova. Do të duhet të merremi me zhvillimin ekonomik, mbi të gjitha me inteligjencën artificiale dhe robotikën, në mënyrë që të mos mbetemi prapa", deklaroi Vuçiç.

Dorëheqja vjen përpara zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të **25 tetorit**. Vuçiç ka deklaruar se do të vazhdojë angazhimin politik pas largimit nga Presidenca dhe do të marrë pjesë në fushatën zgjedhore.

Vuçiç u zgjodh president për herë të parë në vitin 2017 dhe u rizgjodh në vitin 2022. Mandati i tij i dytë do të përfundonte në vitin 2027, por ai vendosi të largohet më herët për t'i hapur rrugë kandidimit për kryeministër.

Pas dorëheqjes, kryetarja e Asamblesë Kombëtare, Ana Brnabić, merr përkohësisht detyrën e presidentes. Sipas Kushtetutës së Serbisë, zgjedhjet presidenciale duhet të zhvillohen brenda 90 ditëve nga përfundimi i mandatit, ndërsa zgjedhjet parlamentare të 25 tetorit zhvillohen veçmas.

Dorëheqja e Vuçiç shënon kështu një zhvillim të rëndësishëm politik në Serbi, në një periudhë kur vendi përgatitet për zgjedhjet e parakohshme parlamentare dhe më pas për procesin e zgjedhjes së presidentit të ri.

Postimet e reja

"Mos hiq dorë nga Kosova"/ Vuçiç jep...

SEPTEMBER 27, 2026

"Liri për çlirimtarët!", qindra qytetarë në Has n...

SEPTEMBER 27, 2026

Zjarr tragjik në banesë, humb jetën 75-vjeçari, i...

SEPTEMBER 27, 2026

Lituanian përgatitet për skenarin e luftës/...

SEPTEMBER 27, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 24, 2026

Dosja/ Biznesmeni Meqemeja i dha Ahmetajt 140 mijë euro! SPAK: Shpërblim për Inceneratorin e Fierit përmes shitjeve fiktive

Biznesmeni Sokol Meqemeja njihet si pronar i disa kompanive apo sipërmarrjeve. Përveç "Delvina Gas" ai...

ALERT në Sloveni për VIPA
Flips të Kosovës, kanë përmbytje të alergjenësh. Produkti hiqet nga tregu

Kreditorët te dera, gjykata në kërkim të "Top Fruits"
të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjonaajt: Paraqituni në gjyq

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Na ndiq

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Dashuri, vendime dhe mundësi të reja: Si do të shkojë e diela për secilën shenjë

Horoskopi/ Parashikimi i yjeve për ditën e sotme, 24 Shtator 2026

Njohje të reja për beqarët, mundësi fitimi dhe sfida në punë, çfarë thonë yjet për ju sot



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu